



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA			
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	1006-031
Nr. i faqeve Br. stranice	9	Data Datum Date	29.12.2023

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Veriore**

Opština Mitrovica Sever - Municipality of Mitrovica North

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE**

Nr. \_\_\_\_\_ . Data: 29.12.2023.

Mitrovicë Veriore.

**RREGULLORE KOMUNALE NR. 03/2023**  
**PËR MBROJTJEN DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE.**

**Dhjetor 2023, Mitrovicë Veriore**

Page 1 of 9

Në pajtim me Nenin 12, paragrafi 2, pika e të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Nenit 125 të Ligjit për Familjen Nr. 2004/32 dhe Statutit të Komunës së Mitrovicës Veriore të datës 15.05.2014, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.12.2023 miratoi:

## **RREGULLOREN**

### **PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve të cilët jetojnë në territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore dhe përcaktimi i masave dhe veprimeve të cilat duhet të ndërmerren nga organet e Komunës së Mitrovicës Veriore me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në frymën e Konventës mbi të drejtat e fëmijës, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989.

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë fëmijët pavarësisht gjinisë, etnisë, gjuhës, religjionit, pasurisë, aftësisë së kufizuar, prejardhjes familjare të fëmijëve, prindërve të tyre apo kujdestarëve ligjor dhe veçanërisht për fëmijët e marginalizuar.

##### **Neni 2 Fushëveprimi**

Me këtë rregullore përcaktohen të drejtat themelore të fëmijës, kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat Komuna duhet t'i ndërmarrë me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës si dhe obligimet e Komunës në raport me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës të cilët jetojnë në territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore.

##### **Neni 3 Përkufizimet**

Foshnjë - fëmijë nga lindja deri në moshën dymbëshjetë (12) muaj

Fëmijë i vogël – fëmijë me moshë nga nj (1) deri në tri (3) vjeç

I mitur – personi ndërmjet moshës katërbëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18)

I mitur i ri – personi ndërmjet moshës katërbëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet

I mitur i rritur – personin ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18)

Fëmijë – personi i cili nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.

Madhor – personi i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet

## **II. TË DREJTAT THEMELORE TË FËMIJËVE**

### **Neni 4**

#### **Parimet themelore**

1. Kjo rregullore bazohet në parimet themelore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të përcaktuar me Konventën mbi të drejtat e fëmijës dhe të njohur nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
2. Parimet themelore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve janë:
  - a. Mosdiskriminimi;
  - b. Interesi më i lartë i fëmijës
  - c. E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit, dhe
  - d. Respektimi i mendimit të fëmijës

### **Neni 5**

#### **Të drejtat kushtetuese të fëmijëve**

1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domodoshëm për mirëqenien e tyre.
2. Fëmijët e lindur jashtë martese, kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë.
3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.
4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.
5. Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

### **Neni 6**

#### **Mbrojtja e fëmijëve:**

1. Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.
2. Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë t'i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë;
3. Fëmijët me të meta të diagnostifikuara mendore ose fizike kanë të drejtë për kujdes të posaçëm, për një jetë të përshtatshme, në kushte të jetës që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën shoqërore.
4. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi ekonomik, eksploatimit të fëmijëve, trafikimit dhe eksploatimit seksual dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rrezik ose që cenon edukimin ose dëmton shëndetin e tyre.
5. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontekstin e familjes, sikurse janë njohja e atësisë, mbrojtja e fëmijës, adoptimi, kujdestaria etj, rregullohen në përputhje me legjislacionin përkatës mbi familjen.

## **Neni 7**

### **Regjistrimi i fëmijëve**

1. Komuna duhet të kujdeset për regjistrimin me kohë të fëmijëve të posalindur.
2. Komuna merr masa të veçanta për sigurimin e regjistrimit të fëmijëve të paregjistruar në regjistrin e gjendjes civile.

## **Neni 8**

### **Arsimimi**

1. Fëmijët kanë të drejtën e shkollimit fillorë falas, të marrjes së informimit për profesione të ndryshme si dhe për shkollat që ekzistojnë.
2. Komuna është e obliguar që të planifikojë dhe ofrojë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.
3. Komuna duhet të kujdeset që institucionet arsimore dhe aftësuese të akomodojnë në të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe kontaktin mes fëmijëve.
4. Komuna është përgjegjëse për regjistrimin dhe pranimin e nxënësve në arsimin publik për nivelet parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, në pajtim dhe me respektimin e parimeve të mos-diskriminimit sipas ligjislacionit në fuqi.
5. Komuna merr masa për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve në shkolla të rregullta të komunës, përfshirë edhe themelimin e dhomave burimore dhe klasave të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara fizike, përfshirë ato ndijore.
6. Komuna merr masa të veçanta për sigurimin e pjesëmarrjes së fëmijëve të grupeve të marginalizuara në arsimimin obligativ.

## **Neni 9**

### **Aktivitetet jashtëmartesore**

1. Komuna, në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për arsim, organizon gara vjetore të diturisë në lëndë të ndryshme për nxënësit e shkollave fillore, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.
2. Komuna, përmes drejtorisë përkatëse të arsimit dhe të sportit, organizon gara vjetore në nivel të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, në sporte të ndryshme për djem dhe vajza.

## **Neni 10**

### **Shëndeti i fëmijëve**

1. Komuna ofron shërbime të kujdesit primar shëndetësor për fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare nga lista e shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor, pavarësisht nga statusi i sigurimit shëndetësor të fëmijës

2. Komuna është përgjegjëse për zbatimin e masave për mbrojtjen parandaluese nëpërmjet programeve të promovimit të shëndetit dhe vizitave sistematike të fëmijëve dhe të rinjve në shkollat fillore, të mesme, dhe të larta në territorin e Komunës.
3. Komuna kujdeset për vaksinimin e rregullt të fëmijëve të cilët jetojnë në territorin e Komunës.
4. Komuna merr masa të veçanta për identifikimin e fëmijëve të pavaksinuar dhe sigurohet për vaksinimin e tyre.

## **Neni 11** **Çështjet sociale**

1. Komuna, përmes njësisë përkatëse për punë sociale, është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj sipas standardit të specifikuar nga Ministria, duke përfshirë:
  - a. Kujdesin për mbrojtjen, rrespektimin dhe përfitimin e të drejtave të fëmijëve të cilat lindin nga skemat e ndihmës sociale në përputhje me legjislacionin në fuqi.
  - b. Mbajtjen e një regjistër të familjeve dhe të fëmijëve në nevojë të cilët jetojnë në territorin e saj, nuk gëzojnë përkrahje nga familja ose komuniteti ose kanë vështirësi që të përkujdesen për fëmijët e tyre, ose kur fëmija është në rrezik ngase lihet pasdore, shfrytëzohet, abuzohet ose në çfarëdo forme tjetër demtohet.
  - c. Caktimin e vizitave të rregullta për ato familje në nevojë që gjenden në regjistrin për shërbime sociale dhe familjare nga një person përgjegjës, në mënyrë që të krijohet siguria dhe mirëqenia e fëmijës dhe t'i sigurohet familjes çfarëdo shërbimi që konsiderohet i arsyeshëm.
2. Në bashkëpunim me familjet, komunitetin, organizatat joqeveritare dhe organet e tjera të caktuara me ligj, Komuna ofron përkujdesje sociale, këshillim social dhe, në rrethana të jashtëzakonshme, asistencë materiale për fëmijët dhe familjet e tyre të cilët janë në nevojë dhe jetojnë në territorin e saj, duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave të tyre për keto shërbime dhe aftësinë e komunës që t'i plotësojë ato mënyra të arsyeshme. Në të gjitha çështjet lidhur me ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme.
3. Komuna, përmes njësisë përkatëse për punë sociale, ofron përkujdesje sociale dhe/ose këshillim në rrethanat kur një fëmijë është në nevojë për shërbime sociale dhe familjare sepse:
  - a. Ai ose ajo është pa përkujdesje prindore;
  - b. Prindi ose prindërit e tij, ose ndonjë përkujdesës tjetër, për shkak të mënyrës së jetesës, paaftësisë ose sëmundjës fizike ose mendore, problemeve psiko-sociale, varësisë ose arsyeve të tjera, kanë vështirësi në ofrimin e nivelit adekuat të përkujdesjes dhe mbikëqyrjes për të;
  - c. Ai ose ajo ka aftësi të kufizuar ose sëmundje mendore;
  - d. Ai ose ajo ka aftësi të kufizuar ose sëmundje fizike;
  - e. Ai ose ajo kanë vështirësi në sjellje;
  - f. Ai ose ajo janë delikuent;

- g. Ai ose ajo janë duke vuajtur si pasojë e konfliktit familjar;
  - h. Ai ose ajo kanë ndonjë formë tjetër të problemit psiko-social që i bën ata persona në nevojë.
4. Komuna, përmes njësisë përkatëse për punë sociale, kujdeset për zhvillimin e procedurës për njohjen e ndihmës materiale, familjes me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme, në përputhje me legjislacionin përkatës për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershëm.

## **Neni 12**

### **Abuzimi me fëmijë**

1. Fëmijët duhet të mbrohen nga keqtrajtimi dhe dhunimi seksual
2. Komuna, përmes njësisë përkatëse për punë sociale, kujdeset për identifikimin e rasteve të abuzimit me fëmijë dhe marrjen e masave konform legjislacionit në fuqi.
3. Çdo pjesëtar i profesionit të mësuesisë, infermierisë, mjekësisë, stomatologjisë, psikologjisë ose i policisë apo profesionist tjetër që ka për detyrë përkujdesjen për fëmijët, i cili dyshon ose ka dëshmi se një fëmijë vuan nga abuzimi fizik, seksual ose psikologjik nga ana e prindit ose përkujdesësit të tij është i obliguar me këtë ligj që t'ia raportojë çështjen drejtorit të qendrës përkatëse të punës sociale.
4. Kur Qendra për Punë Sociale bëhet me dije se ka arsye për të dyshuar se një fëmijë që jeton ose gjendet në territorin e saj, është i braktisur ose bonjak ose duke vuajtur ose i kërcënuar nga çfarëdo forme e dhunës fizike apo mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pasdore ose trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, duke përfshirë abuzimin seksual, përderisa është nën përkujdesjen e prindit(ërve) ose çfarëdo personi tjetër që kujdeset për fëmijën, qendra për punë sociale duhet të marrë çdo hap të nevojshëm për ruajtjen e sigurisë së fëmijës, të raportojë pa vonesë çështjen tek Departamenti i Mirëqenies Sociale dhe të zhvillojë vlerësim gjithëpërfshirës profesional të nevojave të fëmijës për mbrojtje.
5. Komuna bashkëpunon ngushtë me të gjitha institucionet përkatëse për zbatimin e procedurave tjera për mbrojtjen e fëmijës nga çfarëdo abuzimi, konform legjislacionit në fuqi.

## **Neni 13**

### **Martestat e hershme**

1. Personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë.
2. Për shkaqe të arsyeshme dhe sipas kërkesës së tij, gjykata kompetente mund t'i lejojë martesën personit të mitur më të vjetër se gjashtëmbëdhjetë vjet, nëse konstaton se personi ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat e veta martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore.
3. Para se të marrë vendimin, gjykata do të kërkojë mendimin e Organit të Kujdestarisë, do ta dëgjojë të miturin dhe prindërit përkatësisht kujdestarin e tij. Gjukata gjithashtu do të dëgjojë personin me të cilin i mituri ka për qëllim të lidhë martesë, mendimin e institucionit përkatës shëndetësor dhe do të hetojë rrethanat tjera të rëndësishme për vendimin.

## **Neni 14**

### **Punësimi i fëmijëve**

1. Asnjë punëdhënës nuk mund të lidhë kontratë pune me ndonjë person nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç
2. Marrëdhënia e punës mund të themelohet me çdo person prej moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeç.
3. Marrëdhënia e punës mund të themelohet edhe me personat në mes të moshës pesëmbëdhjetë (15) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç, të cilët mund të punësohen për punë të lehta që nuk paraqesin rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose akt nënligjor.
4. I punësuari në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç nuk mund të punojë në punët e rrezikshme, si në vijim:
  - a. Në nëntokë, nën ujë, në lartësi të rrezikshme apo në vende të mbyllura,
  - b. Me makineri të rrezikshme, në pajisjet dhe veglat, të cilat duhen të shfrytëzuar, dhe në transportimin e ngarkesave të rënda;
  - c. Në mjedis jo të shëndoshë, i cili për shembull i ekspozon të rinjtë në substancat e rrezikshme, faktorëve ose proceseve, temperaturave, zhurmave dhe dridhjeve që dëmtojnë shëndetin e tyre;
  - d. Në kushte posaçërisht të vështira siç është puna me orar të gjatë, apo në rrethana të caktuara gjatë natës, puna në mjedis të mbyllur

## **Neni 15**

### **Mbrojtja e fëmijëve nga duhani dhe substancat narkotike**

1. Fëmijët duhet mbrojtur nga përdorimi i paligjshëm i drogave dhe substancave psikotrope dhe nuk duhet lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve.
2. Komuna merr masa për parandalimin e qasjes së të miturve në produkte të duhanit, duke përfshirë:
  - a. Asnjë person nuk lejohet t'u shesë të miturve produkte të duhanit.
  - b. Asnjë person i mitur nuk lejohet të shes produkte të duhanit.
  - c. Asnjë person nuk lejohet, të punësojë një të mitur për të shitur produkte të duhanit.
  - d. Shitësit e produkteve të duhanit me pakicë detyrohen të paraqesin në vendet e tyre të shitjes shenjat për ndalimin e shitjes së produkteve të duhanit personave më të rinj se tetëmbëdhjetë (18) vjeç
3. Asnjë personi nuk i lejohet shitja e ëmbëlsirave, lodrave dhe produkteve tjera të dedikuara për fëmijë, të cilat kanë formë të çfarëdo lloji të prodhimeve të duhanit.
4. Asnjë person nuk lejohet të pijë duhan në ndonjë hapësirë të hapur që është:

- a. Në administrim të institucioneve educative-arsimore;
- b. Vendet e lojërave për fëmijë.

### **Neni 16** **Siguria e fëmijëve në trafik**

1. Komuna obligohet që të sigurojë transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me vështirësi në mësim që ndjekin mësimet në shkollë komunale.
2. Komuna, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, drejtorinë përgjegjëse për arsim dhe këshillat e prindërve, merr masa të veçanta për sigurinë e nxënësve në shkollë dhe përreth hapësirave shkollore.
3. Komuna, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe në konsultim me komunitetin, duhet të bëjë rregullimin Teknik të trafikut nëpër rrugët publike me qëllim të sigurimit të qarkullimit të sigurtë në trafikun rrugor për lëvizje të fëmijëve shkollore në afërsi të institucioneve mësimore, shëndetësore dhe institucioneve të tjera, të fushave sportive, të çerdheve të fëmijëve, të kinemave e të ngjajshme.

### **Neni 17** **Tubimet publike**

Ndalohet organizimi dhe mbajtja e tubimeve publike në afërsi të çerdheve për fëmijë dhe shkollave fillore gjatë kohës së mësimt.

## **I. KUVENDI I FËMIJËVE**

### **Neni 18** **Themelimi I Kuvendit të Fëmijëve**

1. Kuvendi i Fëmijëve themelohet nga fëmijët/nxënësit e shkollave fillore të Komunës së Mitrovicës Veriore.
2. Procedurat e themelimit, funksionimit dhe struktura organizative përcaktohen përmes Statutit të Kuvendit të Fëmijëve.
3. Komuna ofron përkrahje për themelimin, funksionimin dhe për zbatimin e aktiviteteve të Kuvendit të Fëmijëve.
4. Zyra e Kryetarit të Komunës, përmes njësisë përkatëse për të drejtat e fëmijëve, kujdeset për ofrimin e përkrahjes për Kuvendin e Fëmijëve.

### **Neni 19** **Autonomia e Kuvendit të Fëmijëve**

1. Komuna, duke përfshirë edhe organet vartëse të saj, nuk përfshihet në përzgjedhjen e strukturave të Kuvendit të Fëmijëve.
2. Kuvendi i fëmijëve mund të bashkëpunojë edhe me organizata joqeveritare më qëllim të përmbushjes së objektivave të saj



**Neni 20**  
**Pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrje**

1. Komuna sigurohet për zhvillim të konsultimeve me Kuvendin e Fëmijëve gjatë procesit të miratimit të dokumenteve strategjike. Rregulloreve apo akteve tjera komunale të cilat në mënyrë direkte apo indirekte prekin interesat e fëmijëve në Komunën e Mitrovicës Veriore.
2. Komuna sigurohet për përfshirjen e Kuvendit të Fëmijëve në procesin e hartimit të buxhetit të Komunës dhe për përfshirjen e kërkesave të Kuvendit të Fëmijëve në dokumentin final të buxhetit për çdo vit fiskal.
3. Gjatë planifikimit dhe realizimit të projekteve të infrastrukturës, Komuna sigurohet se projektet në fjalë janë të përshtatshme me specifikat dhe nevojat e fëmijëve.

**I. DISPOZITAT PËFUNDIMTARE**

**Neni 21**  
**Përgjegjësia për zbatim**

1. Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje është Zyra e Kryetarit, përmes njesisë përkatëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
2. Komuna bashkëpunon ngushtë me institucionet përgjegjëse të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe me organizatat joqeveritare të cilat punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, me qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

**Neni 22**  
**Raportimi**

1. Komuna publikon raport vjetor mbi nivelin e zbatimit të kësaj rregulloreje.
2. Komuna publikon raport vjetor mbi nivelin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, sfidave dhe problemeve në kuptim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në Komunën e Mitrovicës Veriore.

**Neni 23**  
**Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret e mëparshme

**Neni 24**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në zyrën e protkollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe pas publikimi në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës

**Mitrovicë Veriore.**

Dorëzohet:

1x1 Kryesuesit të Kuvendit

1x1 MAPL

1x1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Të gjitha Drejtorive

